



Implemented by



Raport vlerësimi mbi situatën aktuale të rolit të gruas në zonën e Dibrës

Tiranë, Shkurt 2020

Ky raport është bërë i mundur përmes mbështetjes së GIZ. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë mendimet e GIZ.

Tabela e Përmbajtjes

Parathënie e shkurtër dhe objektivat e projektit.....	3
I. Metodologjia e aplikuar.....	4
II. Situata aktuale e punësimit dhe vetëpunësimit të grave në zonën e Dibrës.....	6
II.1 Të dhënat mbi punësimin dhe vetpunësimin e grave.....	6
II.2 Kuadri ligjor dhe zbatimi i tij.....	11
III. Vlerësimi i nevojave të grave mbi punësimin, vetëpunësimin dhe integrimin në shoqëri.....	13
IV. Vlerësimi i nevojave nga aktoret lokale (bashkia, bizneset lokale, agroturizmet në zone, bujtinat hotelet)	15
V. Konkluzione dhe rekomandime.....	17

Parathënie e shkurtër dhe objektivat e projektit

Gratë dhe vajzat në zonat rurale përbëjnë shumicën e popullsisë që jetojnë në varfëri dhe përjetojnë pabarazi shumëdimensionale. Niveli arsimor i tyre krijojnë kushte të përshtatshme për diskriminim gjinor duke sjellë edhe diskriminim në punësimin e tyre. Edhe pse janë ratifikuar një sërë legjislacionesh ndërkombëtare dhe kombëtare, përsëri grate dhe vajzat jetojnë në pabarazi krahasuar me djemtë dhe burrat.

Mbi 50 përqind e grave shqiptare punojnë në bujqësi - 87 përqind e tyre në punë familjare të papaguara - dhe gratë rurale nuk janë të përfshira nga shërbimet themelore sociale, pensione dhe shëndetësore. Ata përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të forcës totale të punës bujqësore, dhe kontributet e tyre janë kryesisht të padukshme. Ato nuk shihen si "produktive" pasi në përgjithësi pritet të funksionojnë pa pagesë. Gratë e fermerëve në përgjithësi nuk kanë arsim profesional profesional. Gratë dhe vajzat ofrojnë kontributin e tyre në ekonominë bujqësore dhe rurale në të gjitha rajonet. Rolet e tyre ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet dhe brenda rajoneve dhe po ndryshojnë me shpejtësi në shumë pjesë të botës, ku forcat ekonomike dhe sociale po transformojnë sektorin bujqësor. Gratë rurale shpesh menaxhojnë familje komplekse dhe ndjekin strategji të shumta jetese. Aktivitetet e tyre përfshijnë prodhimin bujqësor, blegtorinë, bimët medicinale, përpunimin dhe përgatitjen e ushqimit. Shumë nga këto aktivitete nuk përcaktohen si "punësim aktiv" të grave, por cilësohen si thelbësore për mirëqenien e familjeve rurale.

Aktualisht ka mungesë të të dhënave në lidhje me situatën social-ekonomike të grave në rajonin e Dibrës në mënyrë specifike, por në dokumente dhe raporte të ndryshme strategjike megjithatë theksohet se për shumicën e këtyre grave, puna e tyre në sektorin bujqësor është vetëm burim i të ardhurave për familjet e tyre dhe pa njohuri, aftësi dhe infrastrukturë për të përpunuar dhe ruajtur produktet e tyre - dhe një model biznesi për të hyrë në fonde dhe tregjet - rritja e tyre, fuqia negociuese dhe përfitimi pengohet.

Për më tepër, është e njohur në mbarë botën që fuqizimi ekonomik i grave rrit vetëbesimin e grave, vendimmarrjen dhe liritë shoqërore që çojnë në efekte pozitive në marrëdhëniet gjinore në familje dhe në komunitet. Më në fund, të gjitha këto gra do të shërbejnë si modele të punës dhe suksesit për tërë komunitetin.

Kjo problematikë vërehet edhe në rajonin e Dibrës, ku gratë dhe vajzat ndonëse janë të fokusuar në zhvillimin e bujqësisë dhe të angazhuara në aktivitete ekonomike, roli dhe pozita e tyre në shoqëri lë shumë për të dëshiruar. Dibra është zonë agrare, me potenciale turistike balnerare dhe rurale. Për nga kushtet e zhvillimit ekonomik, zona e Dibrës është e pozicionuar në zonat e fundit (58%) në krahasim me GDP-në mesatare kombëtare (indeksuar në 100). GDP-ja për zonën e Dibrës është 177.111 lekë për frymë, kurse në nivel nacional ajo është 305.229 ALL. Sektorët që kontribuojnë më shumë janë bujqësia, pylltaria, turizmi, ndërtimi, minierat dhe hidroenergji. Dibra është një zonë ku dallohen qartazi ekonomia e zonës rurale dhe ekonomia e zonës urbane. Ekonomia e zonës urbane bazohet kryesisht në sektorin e shërbimeve, tregtisë, hoteleri-turizmit, përpunimit dhe ndërtimit. Territori është rural në më shumë se 91% të sipërfaqes së tij. Ndërsa zona rurale ka karakter të qartë bujqësor. Ajo bazohet në ekonominë familjare të fermave të vogla bujqësore dhe blegtorale, me një tendencë në rritje. Gjithashtu bazohet edhe në disa shërbime bazë dhe biznese tregtare e përqendruar dhe edalluar kjo gjë në zonën e Maqellarës). Këto vitet e fundit ka një fillim të investimeve në përpunimin e produkteve bujqësore, kryesisht të qumështit (rreth 19 baxho), të frutave (punishtëpër lëngje frutash, pijesh alkoolike, kompostosh/reçelnash, të jufkave, etj). Shumica e këtyre bizneseve, në sektorin bujqësor janë me bazë familjare.

Ky projekt mendohet të ketë një ndikim të madh në jetën e tyre në shumë dimensione. Nga këndvështrimi ekonomik mendohet se përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike duke rritur të ardhurat e tyre të cilat njëkohësisht prekin në mënyrë pozitive familjet e tyre. Në aspektin e perspektivës profesionale, të gjitha njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë projektit do të mbeten me ta për pjesën tjetër të jetës së tyre dhe në të ardhmen ata do të kenë mundësinë për të thelluar dhe avancuar më tej.

Nisur nga sa më sipër, iniciativa që po zbatohet “*Fuqizimi i rolit të gruas në zonën e Dibrës dhe promovimi i produkteve lokale*” fokusohet në rajonin e Dibrës dhe ka për qëllim rritjen e fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave. Gjithashtu, nisur nga karakteristikat e zonës së Dibrës, nëpërmjet fuqizimit ekonomik të grave, synojnë promovimin e produkteve lokale që rriten dhe zhvillohen në zonën e Dibrës.

Nëpërmjet iniciativës, synohet ngritja dhe funksionimi i një biznesi për gratë dhe vajzat i cili do të krijoj një mjedis të përshtatshëm për ndryshimin social të tyre.

Objektivat e caktimit dhe përfituesit

Ky projekt synon të forcojë fuqizimin ekonomik të grave përmes promovimit të produkteve tradicionale bujqësore vendase. Duke marrë parasysh situatën e përshkruar më sipër të grave në zonat rurale.

Nëpërmjet këtij projekti synohet të fuqizohen gratë (60 gra në total) të ndara sipas :

- ✓ 50% gra nga komuniteti,
- ✓ 25% gra nga grupi i migrantëve të kthyer;
- ✓ 25% vajza të reja) me njohuri dhe aftësi se si të krijojnë një biznes dhe të promovojnë punën e tyre.

Në të njëjtën kohë me fuqizimin e grave, ky projekt synon :

të promovojë produktet vendore dhe

të zgjerojë tregun e këtyre produkteve

të mundësojë shitjen e produkteve nëpërmjet bashkëpunimit me ofrues lokalë, por jo vetëm, të shërbimeve të turizmit si hotele, shtëpi pritjeje, restorante, dyqane organike dhe agroturizëm.

Kapitulli I

I. Metodologjia e aplikuar

Ky kapiotull përshkruan qasjen metodologjike të këtij vlerësimi, duke parashtruar pyetjet kërkimore, qasjen për mbledhjen e të dhënave, aktorët e përfshirë, aktivitetet e zhvilluara, vështirësitë e hasura si dhe analizimin e të dhënave të përfutuara. Qendra ALTRI zhvilloi dy procese për mbledhjen e të dhënave për secilin grup interesi. Konkretisht së pari u realizua një takim me aktorët e zonës dhe si aktivitet i dytë ishte takimi me gratë dhe vajzat në rajonin e Dibrës:

1. Takimi i parë me aktorët e zonës e u realizua duke ftuar në një diskutim të hapur përfaqësues të bashkive, zyrate të punës, bizneseve lokale dhe organizatat e shoqërisë civile (zyra e informacionit Turistik në Bashkia Dibër, Zyra rajonale e Punësimit qarku Dibër, Drejtoria Rajonale e Statistikave qarku Dibër, përfaqësues të Shkollës Profesionale Nazmi Rushiti Peshkopi. Në këto takime është diskutuar dhe marrë informacion mbi të dhëna për numrin e popullsisë gjithsej dhe grave në veçanti, numri ose përqindja e forces së punës nga gratë, statusi i tyre (niveli i punësimit apo niveli i papunësisë, llojet e profesioneve dhe punëve që aktualisht ofrohen nga zyra e punësimit, niveli arsimor i grave të papuna, mosha e tyre, si dhe të dhëna të tjera që u vlerësuan nga pjesëmarrësit.

2. Ky takim në vetëvete u nda në dy pjesë, pjesa e prezantimit të projektit dhe objektivave që ai synon të arrijë dhe pjesa e dytë ishte diskutimi me aktorët e ftuar, për mbledhjen e të dhënave rreth situatës së grave në zonën e Dibrës, parë kjo nga këndvështrime të secilit prej aktorëve lokalë. Nga takimi u mblodhën të dhëna të cilat pasqyrohen më poshtë në raport.
3. Takim me gratë dhe vajzat e rajonit të Dibrës, të cilat në fakt ishin edhe grupi i synuar për realizimin e objektivave të projektit. Edhe ky takim si takimi me aktorët e zonës, u nda në dy pjesë, pjesa e prezantimit të projektit dhe objektivave që ai synon të arrijë dhe pjesa e dytë menjëherë pas prezantimit ishte diskutimi me gratë e interesuara për të diskutuar mbi nevojat dhe problematikat rreth situatës së grave në zonën e Dibrës, parë kjo nga këndvështrimi i tyre dhe për të ndihmuar më shumë në krijimin e një ideje më të qartë, për nevojat dhe mundësitë që ato kanë. Të dhënat e mbledhura nga takimi janë pasqyruar në këtë raport.

Puna kërkimore u përqëndrua në 6 drejtime kryesore:

1. Identifikimin e drejtpërdrejtë të nevojave, identifikimin e grave dhe vajzave potenciale, mbledhjen e informacionit të detajuar nga targeti i synuar, me qëllim përcaktimin e nevojave dhe aftësive të tyre lidhur me mundësitë për vetëpunësim ose hapje të biznesi për të plotësuar nevoja të zonës ku ata jetojnë;
2. Identifikimin e drejtpërdrejtë të nevojave dhe mbledhjen e informacionit nga aktorët vendor në zonat përkatëse si zyrat vendore të punësimit, bashkitë, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, mbi nevojat dhe problematikat e zonës përkatëse dhe mundësitë potenciale për nxitjen e iniciativave të grave dhe vajzave në vetëpunësim ose hapjen e bizneseve të reja;
3. Vlerësimin e situatës aktuale social-ekonomike të zonave në fjalë lidhur me punësimin dhe vetëpunësimin e grave dhe vajzave si dhe mbi mundësitë apo eksperiencat e suksesshme të cilat janë hasur në zonat e tyre;
4. Vlerësimin dhe analizimin e nevojave dhe të dhënave të mbledhura nga takimet e drejtpërdrejta me gratë dhe vajzat të përfshirë në takimet prezantuese të projektit dhe në takimet me ekspertet e projektit;
5. Vlerësimin e nevojave, informacionit dhe sugjerimeve të aktorëve vendorë të përfshirë në aktivitet me ekspertet e projektit;
6. Konkluzione të nxjerra nga sa më sipër, për të përcaktuar mundësitë potenciale për zhvillimin e ideve të reja, përgatitjen e të rinjve potencialë dhe vijimësinë e aktiviteteve të parashikuara të projektit.

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme mbi situatën aktuale të punësimit, papunësisë, formimit profesional të grave dhe vajzave në rajonin e Dibrës, u zhvilluan takimet me aktorë të ndryshëm të zonës (zyrat vendore të punësimit, bashkitë, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si dhe vete gratë dhe vajzat e përzgjedhura për tu bërë pjesë e këtij projekti) të cilët u mendua se:

- ✓ Kanë të dhëna konkrete dhe statistika lidhur me gratë dhe vajzat;
- ✓ Kanë të dhëna konkrete dhe statistika mbi formimin profesional të tyre;

- ✓ Kanë të dhëna konkrete mbi kërkesat reale të tregut të punës;
- ✓ Mund të shërbejnë për punësimin e grave dhe vajzave ose si mbështetje për hapjen e bizneseve për një pjesë të tyre.

Gjatë Procesit të hartimit të këtij raporti janë ndjekur këto hapa, si:

a) Intervista dhe takime me përfaqësues të institucioneve për marrjen e të dhënave;

Gjithashtu në takime të tjera janë kërkuar të dhëna mbi aftësimin profesional, kurset profesionale që ofrohen për targetin (gra e vajza), degët dhe lëndët që ofron shkolla profesionale për vajzat e regjistruara aty, etj. Një tjetër informacion që kemi kërkuar të marrim nga institucionet ka qenë edhe llojet dhe traditat e gatimeve lokale, ku gjenden, kush i ofron, tregu i tyre, format e promovimit për këto produkte, etj.

b) Biseda me gra e vajza të zonave rurale;

Në bisedat me gratë dhe vajzat është bërë e mundur të evidentohen disa nga problematikat, vështirësitë si dhe rrugët e zgjidhjes sesi ato e shikojnë këtë proces. Këto fokusgrupe kanë qenë gjithëpërfshirëse, me përbërje nga gra dhe vajza me aftësi, profesione, grupmosha, vendbanime e statuse të ndryshme në shoqëri. Vetë gratë dhe vajzat kanë dhënë më informacione mbi traditat e gatimeve lokale, llojet e tyre, kushtet e përpunimit në mënyrë tradicionale, tregjet ku ato i çojnë produktet e tyre, format e thjeshta të marketingut dhe etiketimit që ato bëjnë, promovimi i produkteve, etj.

c) Marrje opinioneve dhe sugjerimeve edhe nga aktorët si organizata lokale dhe njësitë e shërbimeve turistike që veprojnë në terren;

Nëpërmjet bisedave të realizuara me aktorët lokaleorganizata si: Agritra-Vizion, ALCDF, Eorld-Vizion Peshkopi, Agro-Eko Dibra, CNVP apo edhe me disa njësi turistike shërbimi që veprojnë në terren, u bë e mundur marrja e të dhënave për grupet e grave e vajzave që prodhojnë dhe shesin këto produkte, ndërhyrjet e tyre (organizatave) nëpërmjet projekteve që ato kanë implementuar ndër vite dhe në vazhdimësi. Në bisedat me përfaqësues të njësisive të shërbimeve turistike dhe të njësisive tregtare janë marrë opinione mbi llojet gatimeve dhe produkteve të përpunuara që kërkon tregu, sasitë dhe cilësitë e produkteve si dhe format e paketimit të produkteve.

Kapitulli II.

II. Situata aktuale e punësimit dhe vetpunësimit të grave në zonën e Dibrës

2.1 Të dhënat mbi punësimin dhe vetpunësimin e grave

Struktura e punësimit në rajonin e Dibrës mbështetet në sektorin e bujqësisë, në sektorin privat dhe në sektorin publik. Bujqësia dhe sektori privat janë sektorët kryesorë që kanë mbajtur peshën e punësimit në vitet e fundit, duke vazhduar të dominojnë ende. Të dhënat tregojnë se numrin më të lartë të të punësuarve e kemi në sektorin bujqësor (58.6%) dhe sektorin privat jobujqësor (24%), ndërsa punësimi në sektorin shtetëror është 17.4% në periudhën 2014. Struktura gjinore e krahut të punës, e matur kjo në vitin 2014 përbëhet nga 13% femra dhe 87% meshkuj. Dëshmi kjo e një ç'ekuilibri gjinor në punësim.

Ky raport është bërë i mundur përmes mbështetjes së GIZ. Opinioneve e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë mendimet e GIZ.

Sektorët ekonomikë kryesorë

Sektorët kryesorë të ekonomisë në Dibër janë bujqësia dhe turizmi. Bujqësia është sektori kryesor në zonën e Dibrës. Kjo për faktin se lidhet me traditën, përqendrimin e popullsisë (75% e popullsisë jeton në zona rurale) dhe me punësimin (58.6% e të punësuarve).

Turizmi është sektori i dytë prioritar në Dibër dhe njihet për vlerat kurative. Aktualisht, turizmi plotëson nevojat për pushim të rreth 12,000 vizitorëve në vit. Kjo, falë shumë investimeve në hoteleri dhe shtëpi pritëse. Ekziston edhe një mundësi tjetër, ajo e shfrytëzimit të turizmit rural dhe malor, pasi zona ofron shumë potenciale të pashfrytëzuara ende, disa shtëpi pritëse (Bujtina, Hostel, Shtëpiza në stane) janë ngritur dhe po konsolidohen vit pas viti.

2.2 Të dhëna mbi aftësitë e grave në zonën e Dibrës

- Për vetë mënyrat dhe kushtet e jetesës që ato bëjnë, gratë kanë mësuar dhe përvetësuar shumë aftësi si psh,
- ✓ për kultivimin dhe trajtimin e kulturave perimore kryesisht në fushë,
 - ✓ njohje të rritjes dhe mbarështimit të blegtorisë, kryesisht për mish dhe qumësht
 - ✓ njohje dhe aftësi në përpunimin e qumështit dhe nxjerrjen e nënprodukteve të tij.
 - ✓ Njohje dhe aftësi të mbarështimit të shpezëve për mish, vezë dhe shtim.
 - ✓ njohje dhe aftësi në gatimet tradicionale dhe përpunimin e frutave dhe perimeve për komposto, recel, shurup, etj.
 - ✓ si dhe njohje dhe aftësi në punë dore
 - ✓ Njohje dhe aftësi në vjeljen, përpunimin e bimëve aromatike dhe medicinale

2.3 Zanatet e grave dhe trajnimet e kryera

Në lidhje me zanatet e grave që jetojnë në zonat rurale, shumicën e tyre dërmuese mund ti përkufizojmë si shtëpiake të cilat nëpërmjet punës së tyre të përditshme por edhe trashëgimisë kanë arritur të formojnë një bazë të mirë të njohurive mbi gatimet tradicionale të zonës. Përsa i përket trajnimeve, ato janë organizuar dhe vazhdojnë të organizohen nga OJQ lokale si AGRITRA-Vizion e cila ka në focus të saj fuqizimin e pozitave ekonomiko-sociale të grave e vajzave në zonën e Dibrës, por edhe organizatën kombëtare me degë në Peshkopi si Eorld-Vizion e cila ndërhyrjeve dhe punës kryesisht me fëmijët dhe të rinjtë, indirect punon edhe për fuqizimin e familjeve të tyre ku përfshihen e dhe grupi i targetit (gra e vajza) si dhe trajnime të tjera nga CNVP e ALCDF. Ndër vite është punuar dhe janë ngritur grupe grash në komuna të ndryshme të cilat kanë rritur kapacitetet e tyre nëpërmjet aktiviteteve si trajnime, ëorkshop-e, demonstrime praktike, panairë etj mbi aftësimin e tyre në fusha si gatimet tradicionale, brandimi i produkteve tradicionale, ngritja dhe fuqizimi i grupeve prodhuese.

2.4 Të dhëna mbi punësimin e grave,

Shumica dërmuese e tyre janë të angazhuara në bujqësi ose vetëpunësim (ky term vlen vetëm për kontributet që ato kryejnë si të vetëpunësuar në bujqësi për pension pleqërie).

Të dhëna mbi Ndërmarrjet aktive në bashkinë Dibër sipas gjinisë së administratorit/pronarit.

<http://ëëë.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-p%c3%abrgjithshme-dhe-rajonale/tregues-sipas-bashkive/#tab2>

	Viti 2018		
Bashkia	Gjithsej	Burra	Gra
Gjithsej	162,835	121,010	41,825
Dibër	1,290	1,030	260

Drejtoria Rajonale e Punësimit Dibër ka të dhëna vetem për personat punëkërkues, ku këtu hyn edhe gratë dhe vajzat. Gjatë vitit 2019 në zyrën e punës u regjistruan punëkërkues gjithsej 1200 burra e gra, ku nga keto rreth 50% gra. Afërsisht 60% e burrave dhe grave që kërkojnë punë janë me nivel të ulët arsimi kryesisht fillor e pak me të mesme si dhe 50% e punëkërkuesve (burra e gra) janë mbi moshën 45 vjeç. Në të gjitha rastet e referuara e ndërmjetësuar për punësim nga Institucioni janë tek punëdhënës privat kryesisht në sektorin e shërbimeve.

2.5 Llojet e punëve të kryera nga gratë dhe formimi profesional i tyre

Targeti i grupit (gra dhe vajza) që jetojnë në zonat rurale, përgjithësisht merren me punët në bujqësi e blegtori, gatimet. Në lidhje me punët në bujqësi falë traditës së kultivimit të trashëguar brez pas brezi kanë arritur të formojnë njohuri të mira kryesisht për kulturat perimore dhe shumë pak për ato të bimëve të arrave apo pemëtoreve, kjo pasi me kulturat perimore ato (gratë) janë edhe në kontakt të vazhdueshëm. Shumë pak përqindje e papërfillshme janë të angazhuara në institucionet lokale, arsim, shëndetësi apo në iniciativa private si rrobaqepëse, parukiere apo shitëse, etj në qytetin e Peshkopisë.

Në lidhje me formimin profesional, Drejtoria Rajonale e Punësimit Qarku Dibër, ofron kurse të formimit profesional vetëm për profesionin rrobaqepëse, parukiere, estetike. Për vitin 2020 – 2021 është planifikuar që të hapen edhe 2 kurse të tjera në degën Estetike dhe Guzhinier/e. Gjithashtu në këtë kuadër të formimit profesional, shkolla Profesionale Nazmi Rushiti prej 3-4 vjetësh ka përfshirur në kurrikulat e tyre për të rinj vajza e djem edhe degën e teknologjisë ushqimore ku aty mësohet mbi bazat e teknologjisë ushqimore, por edhe të gatimeve tradicionale lokale.

2.6 Të dhëna mbi produktet specifike të zonës

Për vetë specifikat dhe karakteristikat e zonës së Dibrës (si një zonë me shtrirje ku përfshihen edhe terrene fushore si dhe terrene kodrinore e malorte më së shumti, ka bërë që edhe produktet e zonës të jenë produktet specifike dhe të veçanta si në lloje ashtu edhe me shije natyrale. Duke qenë se ato (produktet) më së shumti kultivohen por edhe gjenden në mënyrë spontane, kjo ka bërë që ato të jenë natyrale, gjë që rrit shumë vlerat e këtyre produkteve. Ndër to mund të përmendim: mishin e gjedhit apo të të imtave të cilat rriten dhe mbarështohen në kushte natyrale me mënyra kullosore në natyre dhe jo regjim stallor, gjë që ndikon së tepërmi në cilësinë e produkteve si mishi apo qumështi i tyre. Gjithashtu e njëjta gjë mund të thuhet edhe për produktet bujqësore që kultivohen në fermat e zonës. Ato ruajnë akoma tiparet e produkteve tradicionale të zonës, si dhe pothuajse në shumicën e tyre mund të konsiderohen edhe produkte natyrale, kjo pasi fermerët tanë bazë të plehërimit kanë plehun organik.

Në lidhje me frutat e pyllit dhe bimët aromatike medicinale, mund të themi që zona e Dibrës mbart një potencial shumë të madh. Nga kjo pasuri mbi tokësore, pothuajse të gjithë banorët e zonave kodrinore dhe më së shumti ato malore merren me këto bimë (lulet, fletët, herbat, kokrrat, frutat, rrënjët, lëvoret, etj). Ato janë një ndër burimet kryesore të të ardhurave të tyre gjithë vjetore familjare. Këto bimë për nga veçoritë dhe karakteristikat e tyre sipas nënzonave ku gjenden janë shumë të kërkuara në treg si dhe zënë një peshë shumë të konsiderueshme të të gjithë produkteve që prodhohen dhe përpunohen në zonën e Dibrës e pastaj edhe shiten si në Dibër, Tiranë, Durrës, etj.

2.7 Të dhëna mbi traditat agroushqimore të zones

Zona e Dibrës është e njohur për tradita në gatim, ku ndër të cilat spikat me produktet e brumërave si jufkat, trahanaja, ëmbëlsira tradicionale si sheqerparja e Dibrës, reçelëra e komposto të ndryshme nga frutat si : qershia, kumbulla, ftoi, reçel manafere e boronice (produkte këto shumë të kërkuara në tregje, lëngje frutash pylli si lëngu i thanës, uthulla e mollës, salca me perime (domate) , turshitë e ndryshme me bazë perimet e zonës si dhe gatimet tradicionale si pula me qullë, flija, petullat e malësisë, mishi i qengjit i pjekur në saç, djathi, kosi , gjalpi dhe qumështi i bagëtive që kanë kullotur mbi 2000 metra lartësi. Vlen të përmendet se Zona e Dibrës ka karakteristikë të vetën dhe mbarshon të imta si Delen Rudë, dhe ekotipin e Dhisë së Bulaçit. Janë pikërisht këto rracat të cilat për nga karakteristikat e veçanta që kanë, nxjerrin këto produkte dhe nënprodukte që banorët marrim nga këto bagëti.

Edhe pse gatime relativisht të thjeshta në përbërje, (miell, gjalpë, vezë apo sheqer në përbërje), gatimet e zonës janë plot shije dhe mbi të gjitha organike, janë një nga pikat e forta të kësaj zone. Padyshim që pjata kryesore në sofrën dibrane janë Jufkat e Dibrës, gatimi tradicional i dibranëve.

Gjithashtu në vazhdimësi të traditës së produkteve (hand made) kemi edhe veshje si (veshje për fëmijë, shalla, çorape me dekore, çentro, perde, mbulesa me motive, çanta për gra e vajza etj, punime me mjete tradicionale si rasbuja (e cila shërben për qilima, shalla, sixhade, etj, si dhe produkteve të enëve prej balte si; poçe, qypa, vazo dekoruese, vorba, pjata, etj, por edhe produkte të xunkthit si; shporta zbukuruese e funksionale, karrike, tavolina me material thupre, etj.

2.8 Marketingu dhe promovimi i produkteve të zonës

Shumica e produkteve si reçel, komposto, lëng frutash, erëza aromatike për gatim etj , të gjitha të prodhuara në mënyrë tradicionale, formë të paketimit kanë llojet e ndryshme të kavanozëve. ***Një mangësi vërehet në drejtim të marketimit (etiketimi)***. Gratë dhe vajzat nuk e shohin akoma si një element shumë të rëndësishëm etiketimin (element i cilipërçon tek konsumatorikarakteristikat e produktit, informacion për prodhuesin, cmimin , sasinë , afatet e përdorimit, etj). Në shumicën e rasteve etiketat ju janë prodhuar dhe shpërndarë nga organizatat në kuadër të projekteve të zbatuara. Përsa i përket promovimit të produkteve nga gratë e vajzat ato nuk i kushtojnë shumë rëndësi këtij elementi, por mjaftohen me promovimin nëpërmjet prezantimeve në panairë apo ëorkshope në të cilat marrin pjesë. Gratë që arrijnë ti promovojnë ashtu siç duhet produktet e tyre janë shumë pak. ***Një formë shumë e rëndësishme e promovimit siç është ajo nëpërmjet rrjeteve sociale është pothuajse inekzistente***, (përveç tre katër bujtinave që drejtohen apo bashkëdrejtohen nga gra. Anë negative e këtij aspekti është edhe mentaliteti, vështirësia apo pamundësia e grave e vajzave për ti prezantuar/reklamuar produktet e tyre nëpërmjet rrjeteve sociale, për shkak të një mentaliteti akoma të vrazhdë dhe paragjykes. Një ndër mundësitë që kanë gratë dhe vajzat e zonës së Dibërës për promovimin, lidhjen me bizneset tradicionale si dhe shitjen e produkteve të tyre janë panairët e përvitshme që organizohen në qytetin e Peshkopisë (dy-tre panairë në vit), të Tiranës, disa qyteteve në Maqedoni dhe në pak aktivitete ndërkombëtare, si në Itali. Këto aktivitete janë të mbështetura nëpërmjet organizatave të cilat zbatojnë projekte të kësaj fushe. Disa organizata lokale dhe kombëtare kanë zhvilluar projekte me fokus marketimi dhe brandimi e promovimi i produkteve tradicionale lokale. Aktor tjetër që merret edhe me promovimin e produkteve lokale është edhe zyra e informacionit turistik të bashkisë Dibër e cila e realizon promovimin si nëpërmjet rrjeteve sociale ashtu edhe me aktivitetet e përbashkëta me organizatat dhe institucionet e tjera lokale

2.9 Tregu ku duhet të shiten produktet

Në qytetin e Peshkopisë nuk kemi një treg ditor (vend akomodimi) ku në të cilin të vijnë dhe të shiten prodhimet & produktet lokale. Organizohet tradicionalisht çdo të dielë në një pikë të caktuar tregu i të dielës, kohë ku gratë e zonave rurale, por jo vetëm (edhe burrat) kanë mundësinë të tregtojnë prodhimet e tyre kryesisht, fruta, perime, fasule, patate, arra, gështenja, raki , nënprodukte të qumështit (gjalp, gjizë, djath), vezë, pula, erëza të ndryshme, çaj mali, etj si dhe fidanë perimor të përgatitura në ambientet e fermave të tyre. Ditën e dielë, vihet re një mungesë pothuajse totale të produkteve të përpunuara (komposto, reçel, ëmbëlsira, gatimet tradicionale si Flija, etj), kjo pasi këto produkte kërkohen vetëm me porosi nga blerës individual, restorante apo markete. Një pjesë e vogël e këtyre grave që kanë arritur të ngrejnjë një biznes nëpërmjet prodhimit dhe përpunimit të produkteve tradicionale i dërgojnë/shesin ato produkte përveç pikave markete, restorante apo bujtina në Peshkopi, edhe në zona kryesisht në Tiranë Durrës ku edhe kërkesa për këto produkte është më e madhe. Duhet theksuar që në përgjithësi gratë dhe vajzat që marrin pjesë nëpër panairë e ëork-shoop e janë mbështetur e asistuar nëpërmjet projekteve të organizatave me ambalazhe, paketime, etiketime, transport, dieta , etj.

III. KUADRI LIGJOR DHE ZBATIMI I TIJ

3.1 Kuadri ligjor kombëtar dhe strategjitë

Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020 – “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt” ka nisur zbatimin që në fundin e vitit 2014. Objektivi kryesor i kësaj strategjie është identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitëse të punësimit në vend dhe formimit profesional të forcës së punës me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë të gjithë ciklit të jetës. Në strategji jana parashikuar masa të tilla si bashkëpunim ndërsektorial midis Grupit Këshillimor mbi Politikën për Sipërmarrjen e femrave (MZHETS), SHKP dhe sistemit të AFP.

- ✓ Krijimi i kushteve për nxitjen e punësimit për femrat dhe meshkujt në sektorin e tretë (fokusi i ndërmarrjeve sociale).
- ✓ Rritja e kapaciteteve të OJF-ve, duke përfshirë përmirësimin e njohurive dhe aftësive menaxhuese, për të mbështetur profesionalizmin, formimin mbi ngritjen dhe zbatimin e një biznesi të ri dhe nxitja e “partneritetit të të nxënit”.
- ✓ Trajnimi i kryer për autoritetet vendore dhe rajonale si edhe institucionet e tjera mbi mënyrën e punës me organizatat e sektorit të tretë. Bashkëpunimi midis OJF-ve dhe sektorit të biznesit i promovuar.
- ✓ Nxitja e sipërmarrjes sociale (ekonomia sociale dhe vendet e punës në sektorin e tretë) dhe fuqizimit ekonomik të femrave.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i masave në lidhje me sipërmarrjen sociale.
- ✓ Rritja e numrit të grave dhe vajzave përfituese. Studimi gjurmues në lidhje me përfituesit femra/meshkuj që përparojnë drejt punësimit/ hapjes së një aktiviteti, grupimeve etj. në zonat rurale dhe urbane.
- ✓ Programi i hartuar për këshillimin (mentoring) e grave dhe vajzave i aksesueshëm edhe në zonat rurale.
- ✓ Koncepti i ndërmarrjes sociale (duke përfshirë modelin e kooperativave) i përcaktuar dhe i adresuar nëpërmjet legjislacionit të duhur, nga këndvështrimi rajonal.
- ✓ Strategjitë gjithpërfshirëse të hartuara për fillimin e aktivitetit ku përfshihet konsulenca në one-stop-shop dhe përgatitja e vlerësimit të idesë së biznesit profesional.
- ✓ Formimi modular i siguruar për përgatitjen e konsulencës në fillim të aktivitetit dhe në vazhdimësi, gjatë të paktën vitit të parë të vetëpunësimit.
- ✓ Kualifikimet e kërkuara nga Akti për Biznesin e Vogël në Europë, Treguesit e Stambollit të integruara në modulet e SHKP-së, dhe të pasqyruara në të gjitha masat: në formim, këshillim dhe konsulencë për biznes.
- ✓ Aksesimi në rritje në formim dhe në tregun e punës për femrat, duke mbështetur politikën, masat dhe nismat që synojnë harmonizimin e punës me jetën në familje (psh mjediset për kujdesin ndaj fëmijëve), duke përfshirë zonat rurale.

Strategjia ka në qendër të saj rritjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës dhe të sistemit të kualifikimeve.¹

¹ Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2014-2020

Kuadri ligjor në fushën e Ligjit të Punës është prezantuar parimisht nga Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, miratuar paraprakisht më 12.07.1995. Ndryshimet e fundit të Kodit të Punës në vitin 2015 u transpozuan rreth 16 direktiva të BE-së mbi ligjin e punës.

Ligji bazë në fushën e punësimit është Ligji Nr . 7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar. Qëllimi i këtij ligji është ndjekja e politikave aktive të përgjithshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht, nëpërmjet sigurimit që të ketë punë për të gjithë ata që kërkojnë punë, një punë e tillë të jetë sa më produktive që të jetë e mundur, të ketë liri në zgjedhjen e punës dhe mundësitë më të plota të mundshme për çdo person të punësuar, që të kualifikohet dhe të përdorë aftësitë dhe dhuntitë e tij në një punë ku ai është përshtatur siç duhet. Ky ligj shoqërohet nga një seri aktesh nënligjore që synojnë të bëjnë të mundur zbatimin sa më të mirë të tij. Në këto akte nënligjore janë parashikuar një seri politikash të reja, që synojnë punësimin e të rinjve, grupeve të marginalizuara, femrave të kthyer nga emigracioni etj.

Programet e nxitjes së punësimit administrohen dhe zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me institucione të tjera publike përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe kualifikimim, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe shoqërinë civile. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontraktojë subjekte të tjera publike, private apo shoqëri civile, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit. Kështu programet e nxitjes të parashikuara janë:

Programet e garancisë rinore, që janë programe të cilat po përdoren nga vende të ndryshme të Evropës gjatë tri viteve të fundit. Këto programe parashikojnë angazhimin e të rinjve të regjistruar si punëkërkuar të papunë, që brenda një periudhe disa mujore të angazhohen në një nga programet të cilat zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, si programet e nxitjes së punësimit për punësim të menjëhershëm, praktikant profesional, formim nëpërmjet punës dhe arsim apo formim profesional.

Programi “transport për në vendin e punës” i cili ka parashikuar rastet kur vendi i punës është larg vendbanimit të punëkërkuarit dhe për të mospenguar punësimin, ky program do të parashikojë mbështetje për transportin.

Programet e formimit profesional, si pjesë të programeve aktive të tregut të punës, janë parashikuar që ky program t’u shërbejë si punëkërkuarve edhe punëdhënësve dhe realizohet nëpërmjet proceseve mësimore dhe kurseve të mësimin teoriko–praktike. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të jetë institucioni që zbaton programet e formimit profesional dhe do të ofrojë:

- ✓ kurse pa pagesë për punëkërkuarit e papunë;
- ✓ kurse me pagesë për persona që e kërkojnë një gjë të tillë;
- ✓ mjedise dhe mjete logjistike kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional.

Ligji Nr 145/2015 “Për punëkërkuarit e papunë” ka për qëllim realizimin e misionit të zyrave të punësimit për të ofruar sa më shumë mundësi punësimi dhe kualifikimi për punëkërkuarit e papunë, në mënyrë të veçantë për përfituesit e mbështetjes me të ardhura, për t’i integruar ata në tregun e punës. Nxitja e punësimit është ndër programet aktive që nëpërmjet sigurimit të punësimit të përkohshëm apo afatgjatë ndikon në kërkesën për punë duke reflektuar drejtpërsëdrejti në uljen e papunësisë. Përmes këtij programi Zyrat e Punësimit ndërhyjnë për të nxitur dhe mbështetur krijimin e vendeve të reja të punës duke

bashkëpunuar me punëdhënësit dhe nëpërmjet subvencionimit të tyre. Kuadri strategjik i punësimit dhe aftësive synon zbatimin e masave dhe programeve me qëllim që:

- ✓ Të nxisë mundësitë për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme;
- ✓ Të ofrojë arsim dhe formim profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;
- ✓ Të nxisë përfshirjen sociale dhe kohezionin territorial;
- ✓ Të fuqizojë qeverisjen e tregut të punës dhe të sistemeve të kualifikimit.

Në vitin 2011 u krijua Agjencia për Nxitjen e Biznesit Social në Shqipëri. Kjo është një agjenci shtetërore dhe misioni i saj është të ndihmojë në përmirësimin e politikave qeverisëse për mbrojtjen sociale, proceset e përgjegjshmërisë dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

"Nxitja e Biznesit Social" dhe "Nxitja e Grave në Biznes" janë përfshirë gjithashtu në Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2013-2020, si edhe në Planin e Veprimit për Sipërmarrjen e Grave 2014-2020. Legjislati për ndërmarrjet sociale siguron një bazë të mirë për të mbështetur financiarisht iniciativat për startupe të llojit social. Megjithatë gjatë zbatimit vërehen probleme, pasi një pjesë e mirë e të rinjve, por jo vetëm nuk kanë besim në aplikimet përkatëse si dhe u mungon iniciativa dhe aftësitë për të nisur një sipërmarrje të tillë, prandaj ndërmarrjet sociale kanë akoma sfida përpara.

IV. VLERËSIMI I NEVOJAVE TË GRAVE MBI PUNËSIMIN, VETËPUNESIMIN DHE INTEGRIMIN NË SHOQËRI

Duke parë gjendjen aktuale si dhe tendencat e rritjes dhe zhvillimit të sektorit rural në zonën e Dibrës si një nga sektorët me burimet kryesore të të ardhurave për banorët e Dibrës, del e nevojshme që gratë dhe vajzat janë një potencial i pashfrytëzuar referuar popullsisë dhe përqindjes që zënë ato, por edhe për nga aftësitë që ato zotërojnë dhe vendin që ato kanë në fushën e zhvillimit rural, agroturizmit dhe kulinarisë tradicionale. Nëpërmjet përfshirjes dhe aktivizimit të tyre për të qenë një aktor kyç në sipërmarrjet familjare, gratë dhe vajzat do të mund të integrohen plotësisht si dhe të marrin edhe role drejtuese, pse jo në këto sipërmarrje, gjë e cila do të çonte edhe në zhvillimin e fuqizimit e pozitave social-ekonomike të tyre në shoqëri.

4.1 Sfidat dhe problematikat që hasin

Një nga sfidat që haset dhe më kryesorja është akoma mentaliteti që ndikon në zonë. Ky është një fenomen shumë frenues për përfshirjen dhe fuqizimin e pozitave të gruas rurale Dibrane që në shumë nënzona (fshatra) apo njësi Administrative të bashkisë Dibër e gjejmë rëndom. Tjetër problematikë akoma ngelen burimet dhe mjetet që duhet të kenë këto gra e vajza për të vazhduar një sipërmarrje me drejtim Agroushqimor. Tjetër pengesë ngelet edhe çështjet të karakterit pronësor, ku truallin dhe asetet janë në pronësi të bashkëshortëve apo të personave familjarë të tjerë që banojnë së bashku. Kjo e step dhe e frenon gruan të ndërmarrë iniciativa vetëpunësimi falë aftësive dhe njohurive që ajo merr edhe nëpër trajnime apo seminare.

4.2 Aftësitë e grave mbi prodhimin e produkteve lokale

Siç edhe e përmendëm edhe më lart, zona e Dibrës ashtu si çdo zonë tjetër ka karakteristikat dhe tiparet e saj dalluese, tipare këto që reflektohen si në tradita, gatime, etnokulturë, mënyra e jetesës, veshjeve, mikpritjes, etj. Nga kjo gjë nuk bëjnë përjashtim edhe 13 gratë e vajzat e zonës së Dibrës. Ato referuar edhe

mënyrës së jetesës kanë përvetësuar dhe transmetuar brez pas brezi traditat, mikpritjen, aftësitë në punime me dorë HAND MADE për veshje e orendi shtëpiake të ndryshme ashtu edhe në gatimet tradicionale. Këto gatime i gjejmë të ndërthurura edhe sipas krahinave, ku çdo krahinë ka nga një apo dy gatime karakteristike tipike të asaj treve.

4.3 Produktet lokale që prodhohen nga gratë ku dhe si shiten ato

Produktet lokale të zonës së Dibrës, duke ju referuar edhe të gjithë faktorëve të tjerë si: klima, toka, uji, puna e njeriut apo edhe farërat dhe materialet mbjellës, kanë bërë që këto produktet të kenë shije dhe aromë natyrale. Të njëjtën gjë mund të thuhet edhe për frutat dhe bimët spontane që rriten në pyje, kodrina apo male. Madje këto fruta apo bimë mbajnë pa hezitim të gjitha karakteristikat e produkteve BIO.

Nga këto lëndë dhe prodhime falë edhe aftësive të grave e vajzave në gatime e përpunime, rezultojnë produktet si: wmbëlsirat e ndryshme dhe jufkat që tashmë janë bërë të famshme dhe që mund të gatuhen si me pulë ashtu edhe me mishin e qingjit, trahananë karakteristike të Dibrës, pastërmanë e deles, flija etj. Për të kaluar tek frutat dhe perimet e përpunuara për komposto qershije, kumbulle, ftoi e pjeshke, reçel qershije, ftoi, kumbulle, reçel boronice dhe manafere (këto shumë të kërkuara, për vetë origjinën e tyre), turshitë e ndryshme, kryesisht me lakër, trangull, domate jeshile e karrota, si edhe erëzat karakteristike të Dibrës si Shafrani i Korrabit, lisna e kodrinave edhe kjo një nga erëzat më të kërkuara etj. Aktualisht këto produkte shiten me porosi direkte, në pak dyqane apo markete të qytetit, në pak restorante të qytetit, në raste kur ka panairë në Peshkopi, (2-3 panairë në vit). Një pjesë shumë e vogël e grave marrin pjesë edhe në panairët në Tiranë e rrallë edhe ato ndërkombëtare (por këto ngelen në iniciativa projektesh 6-12 mujore)

4.4 Cfarë mendojnë gratë se mund të bëjnë, por që kanë nevojë

Përgjatë takimeve dhe fokusgrupeve me gratë e zonave të ndryshme, shihet se ato kanë aftësi shumë të mira në gatimet tradicionale të zonës por edhe aftësi në teknologjitë e përpunimit në kushte tradicionale. Një nga mangësitë apo pamundësitë e grave qëndron tek mungesa e informacionit për tregjet ku këto produkte janë shumë të kërkuara.

Gjithashtu produktet që ato përpunojnë dhe gatuajnë, ngelen akoma në sasi të vogla, pasi sejcila nga gratë pordhon dhe përpunon individualisht si dhe gjen hapësira për shitjen e prodhimeve po individualisht. Kjo ka bërë që ato të stepen / tërhiqen, pasi e kanë pothuajse të pamundur të përballojnë një apo më shumë biznese (markete, bujtina, hotele, etj). Mungesa e bashkëpunimit në treg vërehet rëndom tek të gjitha pothuajse pa përjashtim. Këto gra kanë nevojë pikë së pari që të kuptojnë se bashkëpunimi mes tyre (për produkte të njëjta) ju sjell atyre shumë dobi.

4.5 Nevojat për trajnime, për ndihmë dhe këshilla

Gratë me gjithë aftësitë dhe njohuritë e marra edhe nga trajnimet për këto fusha, ato akoma kanë nevojë për rritje kapacitetesh të tipit trajnime:

- ✓ Si të fillojmë një biznes,
- ✓ Si të gjejmë klientët e duhur për produktet e tyre specifike, format e marketingut të produkteve, mënyrat e paketimit të produkteve,
- ✓ Si të japim vlerë produkteve tipike tradicionale etj.

Gjithashtu një proces shumë i rëndësishëm është edhe faza e mentorimit të këtyre grave e vajzave. Ato duhet të asistohen me këshilla me karakter të tipit për zhvillimin e sipërmarrjeve Start-Up.

Një tjetër mundësi që ato kanë është edhe përfshirja në grupime apo shoqata. Kjo gjë do tju mundësonte atyre që të rrjetëzohen dhe nëpërmjet këtij rrjetëzimi ato (gratë) mund të gjejnë më mirë tregun dhe klientelën si dhe për një shkëmbim mallrash dhe shërbimesh më të qëndrueshëm. Avantazh tjetër i grupimit është edhe sigurimi materialeve, produkteve dhe paketimeve më çime më të leverdishme, pasi për sasi të konsiderueshme ke mundësi negociimi për çmimet e tyre. Bashkëpunimi në grupime , gjithashtu të ofron edhe avantazhin e marrjes së informacionit më të shpejtë si për tregjet, për teknologjitë apo edhe trajnimet në grup.

4.6 Nevojat për financime dhe pajisje

Gratë dhe vajzat që kanë aftësi në gatime dhe iniciativa për të drejtuar dhe çuar përpara një sipërmarrje ju nevojiten burime financiare apo edhe pajisje të tipit; makineri për prodhimin e jufkave, rafte për tharjen natyrale të jufkave, pajisje dhe orendi për përpunimin e frutave për reçel dhe komposto, paketime për produktet (lloje të ndryshme kavanozësh), lloje të ndryshme të etiketave për këto produkte etj.

Këto mund të sigurohen në forma të ndryshme, si:

- ✓ donacione nga projektet e organizatave,
- ✓ kredi bankare ose të institucioneve të tjera financiare që kreditojnë fushat e zhvillimit rural,
- ✓ fonde të mbështetura nga AZHBR
- ✓ fonde të IPARD-it.

Një shtysë shumë e mirë për këto gra e vajza do të ishin fondet që sigurohen nëpërmjet aplikimeve të skemave IPARD, por në këto skema me gjithë stimulimet që janë ofruar për këtë kategori, gratë dhe vajzat nuk mund t'i përthithin këto fonde pasi dokumentacioni që kërkohet në këto aplikime është pothuajse i pamundur dhe këtu shkak kryesor dhe më i rëndësishëm është pronësia mbi truallin apo objektin që gratë duhet të disponojnë.

Deri më tani vetëm disa pak gra në kuadër të grupimeve kanë mundur të sigurojnë disa pajisje, orendi apo rafte e mjete të tjera që ju shërbejnë në punën e sipërmarrjet e tyre, por kjo gjë është e pamjaftueshme referuar aftësive të tyre dhe potencialeve që ofron zona për produkte tradicionale lokale.

V. VLERËSIMI I NEVOJAVE NGA AKTORET LOKALE

- ✓ Në territorin e bashkisë Dibër ushtrojnë aktivitetin e tyre shumë biznese lokale, hotele, bujtina etj. Këto aktorë biznese duke parë edhe trendin e kohës si dhe kërkesat në rritje nga ana e vizitorëve dhe ku turistët që preferojnë zonën e Dibrës janë të prirur për të njohur dhe shijuar produkte tradicionale lokale, kanë rritur kërkesat e tyre për këto produkte si gatimet tradicionale dhe ushqimet e përpunuara.
- ✓ Aktualisht disa gra e vajza që e kanë formë të vetëpunësimit këtë sipërmarrje po përballen gjithnjë e në rritje me kërkesa të reja nga këto hotelet, bujtinat apo marketet.
- ✓ Veçanërisht kërkesat më të mëdha për produkte dhe gatime tradicionale kanë sektori i hotelerisë dhe bujtinave. Ato hera herës po përballen edhe me mungesë të këtyre gatimeve apo produkteve të përpunuara.

- ✓ Gjithashtu vërehet mangësi edhe në sigurimin e një stafi me këto cilësi të mira në gatime si nga hotelet ashtu edhe nga bujtinat.
- ✓ Faktori kryesor i mungesës së stafeve të kualifikuara në këto njësi shërbimi ngelet punësimi sezonal që këto njësi shërbimi ofrojnë por edhe mënyra e trajtimit me pagesë, apo kushtet për punë.
- ✓ Me rritjen e shtuar të vit pas viti të numrit të turistëve dhe rrjedhimisht edhe të njësive akomoduese nëpër bujtina, hostele, hotele apo edhe kampe malore, del si domosdoshmëri edhe ofrimi në sasi më të shtuar i produkteve të përpunuara dhe gatimeve tradicionale. Kjo gjë kërkon shtimin e numrit të grave me aftësi në këto gatime në mënyrë që tju përgjigjen kërkesave të njësive akomoduese.
- ✓ Institucionet vendore në bashkëpunim me strukturat e tjera si zyrat e punës, Shkollat profesionale, dhe ofj e ndryshme që veprojnë në rajon duhet të hartojnë Strategji të territorit për pothuaj të gjitha fushat e veprimit e në veçanti edhe në sferën e zhvillimit rural, agrutorizmit dhe kulinarisë tradicionale.
- ✓ Aktualisht në bashkinë dibër, ekziston Strategjia territoriale e Bashkisë Dibër e hartuar në vitin 2016 nga ALCDF dhe Strategjia e zhvillimit të turizmit në zonën e vargmalit të Deshatit, Dibër (2014-2019) nga ANTARC të cilat shërbejnë si një guidë për iniciativa dhe plane veprimi.
- ✓ Vlen të theksohet se disa organizat si ALCDF, CNVP, AGRITRA-VIZION, CBS, SARED, nëpërmjet projekteve të tyre të implementuara kanë ndërhyrë fushën e turizmit dhe zhvillimit rural dhe kulinarisë tradicionale në disa njësitë akomoduese (bujtina, shtëpi pritëse) me trajnime, vizita studimore, shkëmbime eksperiencash Brenda dhe jashtë vendit si dhe me asete në ndërtime, pajisje e orendi për këto njësi akomoduese.

Raste suksesi

Ka disa punishte tradicionale të prodhimit të brumërave (Jufka e trahana) të cilat në shumicën e tyre drejtohen nga gratë, ndër to mund të përmendim; Dashurie Zerja, Flutura Begu, Lirije Rexha, Elmira Voka, Emrie Lata, etj etj.

Bujtina e Jufkave, (ish Agro – Zerja)

Një ndërmarrje kjo e konsoliduar tashmë e cila udhëhiqet nga zonja Dashurie Zerja. Prej gati 20 vitesh ajo që në fillimet e para rreth viteve 2000 ajo (Dashja) merrte pjesë rregullisht nëpër trajnime e seminare që organizonin organizatat lokale dhe jo vetëm, kryesisht në qytetin e Peshkopisë. Në bazë të formimit që ajo ka përvetësuar nëpërmjet këtyre aktiviteteve por edhe aftësisë së saj për gatimet tradicionale si: Jufka, trahana, ëmbëlsira, kompostot, reçel, shurup, salcat, frutat e thata, turshitë, të gjitha këto me lloje të ndryshme frutash e perimesh të zonës së Dibrës. Produktet e mësipërme sot tregtohen në Peshkopi në shumë markete, në Tiranë tek disa dyqane me drejtim Agro Food, si dhe të kërkuara edhe në pjesën e Dibrës së Maqedonisë së Veriut). Falë përkushtimit të saj në këtë sipërmarrje si dhe mbështetjes nga ana e familjes, Dashja sot drejton sipërmarrjen e parë që menaxhohet nga një femër e cila (Bujtina e Jufkave, tashmë një ndërmarrje e konsoliduar si në asete edhe në staf). Kjo sipërmarrje është bërë një burim frymëzimi edhe për disa nga gratë e tjera me të njëjtat aftësi por me mungesë burimesh.

Punishte Tradita Dibrane e Jufkave

Një sipërmarrje familjare e cila drejtohet nga zonja Flutura Begu. Edhe Flutura si pjesë e disa grupeve të ngritura nga organizata Agritra-Vizion, ka ndjekur rregullisht trajnimet, seminarët, ëorkshopet e më vonë edhe pjesëmarrëse në panairë që organizoheshin kryesisht nga Agritra-Vizion. Ajo merret kryesisht me prodhimin e brumërave si: jufkave dhe trahanasë, si dhe me ëmbëlsira si sheqerpare, baklava, fli, llallangia (palaçinka), por edhe me përpunimin e frutave për komposto. Këto produkte ajo i tregton në Peshkopi dhe në disa supermarket e markete në Tiranë. Gjithashtu ajo merr pjesë rregullisht edhe në panairët vjetore ndërkombëtare në Itali ku prezanton produktet lokale të Dibrës.

Federata e grave rurale Dibër

Është një entitet e cila përmbledh disa grupime dhe shoqata të cilat janë ngritur nga organizata Agritra-Vizion Peshkopi dhe në përbërjen e tyre ka drejtuese dhe anëtare vetëm gra dhe vajza. Ndër to mund të përmendim:

- ✓ **Shoqata “Shija në frutat e pyllit Staravec”** me drejtuese znj. Shpresa Tomçini
- ✓ **LAG-Drini** me drejtuese znj. Fllanxa Shehi
- ✓ **Përpunueset e frutave Begjunec** me drejtuese znj. Esma Nuredini
- ✓ **Tradita e Jufkave Vakuf** me drejtuese znj. ElmiraVoka
- ✓ **Punime artizanale Muhur** me drejtuese znj. Flutura Lleshi
- ✓ **Prodhuesit e perimeve Deshat** me drejtuese znj. Lirije Basha

si edhe disa individë (gra e vajza nga fshatra të ndryshme të zonës së Dibrës) të cilat luajnë rolin e lidereve në grupet e grave e vajzave në fshatrat e zonat respektive ku ato jetojnë. Këto grupime ushtrojnë aktivitetet e tyre në fushën e prodhimit dhe përpunimit dhe tregtimit të produkteve dhe nënprodukteve bujqësore dhe blegtorale të zonës Dibrës.

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Gjetjet

- ✓ Ka mungesë të të dhënave zyrtare në sit-et e tyre si nga ana e institucionit INSTAT ashtu edhe nga Bashkia Dibër. Nga këto të dhëna të fushave të ndryshme si : popullsia, lëvizjet demografike, grupmoshat aktive për punë, të dhëna për arsimimin, aftësimin profesional, produktet karakteristike të zonës, apo të dhëna me karakter të zhvillimit rural si ; prodhimi bujqësor e blegtoral, agroturizmi, etj.
- ✓ Grupe grash e vajzash të cilat kanë marrë trajnime në fushën e agroturizmit dhe kulinarinë dhe produkte Hand-Made, por që akoma nuk janë të gatshme të marrin përsipër dhe të zhvillojnë një sipërmarrje, kjo për faktin se legjislacioni fiskal i detyron ato që në fillim të herës të shlyejnë detyrimet tatimore (sig.shoq + shënd, taksat vendore, kasa, dokumentacioni, etj) .
- ✓ Mungesa e hapësirave/ambjenteve të përshtatshme për të prodhuar/përpunuar më shumë produkte tradicionale , kushtëzon gratë dhe vajzat për të shtuar kapacitetet e prodhimit të produkteve tradicionale.
- ✓ Marketingu i produkteve tradicionale të zonës së Dibrës nga ana e vetë prodhueseve (grave) në mënyrë të vazhdueshme, lë shumë për të dëshiruar apo pothuajse është inekzistent, përveç dy tre rasteve.

Rekomandime

Institucionet vendore si Bashkia Dibër duhet të ndërhyjnë me mekanizma lehtësues për nxitjen e iniciativave nga gratë e vajzat. Këto mekanizma duhet të konsistojnë në reduktimin apo heqjen e barrës së taksave bashkiake për një periudhë 6-12 mujore. Shikimin e mundësive të dhënies pa qera apo me qera të ulët për gratë e vajzat, të ambjenteve në pronësi të Bashkisë Dibër të cilave (grave) do tju lejojnë të ushtrojnë aktivitetet si në grupime apo në mënyrë individuale.

Institucionet si zyra e Punësimit duhet të monitorojnë dokumentacionin në sektorin privat e veçanërisht njësitë e shërbimit pasi kjo bën që shumë oferta për punë të refuzohen nga punëmarrësit (gra e vajza) pasi kushtet si (paga, orari, lejet, etj) janë të disfavorshme.

Krijimi i një database të dhënash në faqen zyrtare të bashkisë Dibër, në mënyrë që këto të dhëna të mund të aksesohen dhe përdoren si burim informacioni për fushat e ndryshme por edhe të zhvillimit rural. Nëpërmjet këtyre të dhënave çdo sipërmarrës/e Start-Up , ekzistues apo donator të mund të ketë parasysh situatën aktuale duke i analizuar këto të dhëna por edhe duke ndërmarrë iniciativa në bazë të këtyre të dhënave.

Institucionet përgjegjëse si Zyra e punës por edhe me nxitjen e pushtetit vendor duhet të mundësojnë hapjen e kurseve profesionale për gratë e vajzat në drejtimin Kulinari & Gatime tradicionale Dibrane.

Ky dokument u mbështet në të dhënat e :

1. Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe aftësi 2014-2020 – “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt”
2. Strategjisë Territoriale të Bashkisë Dibër 2016 ALCDF
3. Strategjisë së Zhvillimit të Turizmit në zonën e vargmalit të Deshatit, Dibër (2014-2019) ANTARC
4. Studimit mbi Tregun e Punës (Kukës, Dibër, Tiranë, Durrës) Nëntor 2018
5. Publikimeve nga INSTAT
6. Intervistimeve në terren e fokusgrupe me grupet target
7. Planit Strategjik 2015-2020 Qendra AGRITRA-VIZION Peshkopi